Ambalazhimi: Në thasë të pastër, 25- 50 kg neto me elementë marketimi.

Produkti ushqimor kur te levrohet duhet të jetë i shoqëruar me certifikaten e origjines dhe flete analizë per treguesit e sigurise dhe cilesise sipas legjislacionit ne fuqi per ushqimin. Te gjithë treguesit organo-leptike dhe fiziko-kimikë te produktit te ofertuar që përfaqësojnë

artikullin duhet të përputhen plotësisht me treguesit e shënuar në specifikime teknike dhe standartin shtetëror përkatës.

24. SELINO

Bazuar ne SSH 1714:1988 ose ekuivalentin e tij.

Klasifikimi - Lloji : cilësi e parë, e freskët

Kërkesat cilësore

Treguesit shqisorë:

- *Pamja e jashtme:* Të pastra të freskëta, me gjethe të pa çara e të pa zverdhura, me ngjyrë karakteristike të kultivarit. Për selinon (rrënjët) të jenë të formuara e të padëmtuara

- *Dëmtime, sëmundje:* Nuk lejohen.

- *Madhësia :*

a) Kultivarët me gjethe e fruta të mëdha: 300-800 (rrënjoret), 100 (gjetthore)

b) Kultivarët me gjethe e fruta të vogla : 200- 500(rrënjoret), 50(gjetthore)

Ambalazhimi, etiketimi, verifikimi i kërkesave cilësore, ruajtja dhe transportimi Sipas SSH ISO 7558:1988 “Udhëzues për para paketimin e frutave dhe perimeve” ose ekuivalentin e tij.

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organoleptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit. Transporti i produkteve të freskta bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjieno – sanitare për transportimin e produkteve ushqimore

25. SODË BUKE

Kërkesat cilësore

Treguesit shqisorë:

- *Ngjyra:* E bardhë.
- *Era dhe shija:* Me shije të kripur pa erë.
- *Konsistenca:* Pluhur kristalin.
- *Tretshmëria në ujë:* Tretet plotësisht në 12 pjesë ujë, ka reaksion alkaline.

Treguesit fiziko- kimik:

- *Bikarbonat natriumi*, %, jo më pak se 99,5.
- *pH (5 %, 20°C)*: 8.0

Ambalazhimi dhe etiketimi

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit. Soda e bukës të ambalazhohet në qese polietileni me vëllime sipas kërkesave të AK-së.

Mbi çdo ambalazh vendoset etiketa ku shënohen:

- Emërtimi i prodhuesit,
- Emri i produktit,
- Pesha neto,
- Data e prodhimit,
- Data e skadimit,
- Kushtet e vecanta të ruajtjes.

Verifikimi i kërkesave cilësore

Marrja në dorëzim bëhet me parti. Verifikimi i kërkesave cilësore bëhet për çdo parti sipas metodave të analizave të miratuara nga organi i emërtesës.

Ruajtja dhe transportimi

Transporti të bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga faktoret atmosferike duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore dhe që nuk ndikojnë në karakteristikat dhe cilësinë e produktit dhe sigurojnë ruajtjen e tij higjienike

Produkti ushqimor kur të levrohet duhet të jetë i shoqëruar me certifikaten e origjines dhe flete analizë për treguesit e sigurise dhe cilesise sipas legjislacionit në fuqi për ushqimin. Te gjithë treguesit organo-leptike dhe fiziko-kimikë të produktit të ofertuar që përfaqësojnë artikullin duhet të përputhen plotësisht me treguesit e shënuar në specifikime teknike dhe standartin shtetëror përkatës

26. DOMATE

Treguesit cilësor:

1.Pamja e jashtme:

Me ngjyrë e formë tipike të kultivarit ,të freskëta ,të pastra dhe me pjekuri teknike.

2.Dëmtime e sëmundje :

Nuk lejohen.

3.Të kalbura ,të mykura,të ngrira:

Nuk lejohen

Të jenë të cilësis së parë të freskëta dhe të pa dëmtuara,perimet të jenë të gjitha llojet, dhe frigoriferike për perimet jo të stinës.

Të mos kenë prani të barërave të tjera

Të jenë të plota dhe të pa dëmtuara jo të vyshkura.

Për produktet ushqimore te fresketa fruta-perime cdo sasi e mallit të lëvruar nga operatori ekonomik fitues do të shoqërohet me fletë analizat ku do te shenohet sasia e prodhimit qe i referohet kjo flete analize.

27. TRANGUJ

Treguesit cilësor:

1.Pamja e jashtme:

Me ngjyrë e formë tipike të kultivarit ,të freskëta ,të pastra dhe me pjekuri teknike.

2.Dëmtime e sëmundje :

Nuk lejohen.

3.Të kalbura ,të mykura,të ngrira:

Nuk lejohen

Të jenë të cilësis së parë të freskëta dhe të pa dëmtuara,perimet të jenë të gjitha llojet, dhe frigoriferike për perimet jo të stinës.

Të mos kenë prani të barërave të tjera

Të jenë të plota dhe të pa dëmtuara jo të vyshkura.

Për produktet ushqimore te fresketa fruta-perime cdo sasi e mallit të lëvruar nga operatori ekonomik fitues do të shoqërohet me fletë analizat ku do te shenohet sasia e prodhimit qe i referohet kjo flete analize.

28. QEPË

Qepa duhet të jetë e thatë të pa mbira të pa dëmtuara jo të kalbura të pa prera të pastra dhe me diametër 4-5cm.

Me lageshti të lejuar 0.16 %.

Ambalazhimi në thasë polietileni me peshë deri në 10-20 kg.

Për produktet ushqimore te fresketa fruta-perime cdo sasi e mallit të lëvruar nga operatori ekonomik fitues do të shoqërohet me fletë analizat ku do te shenohet sasia e prodhimit qe i referohet kjo flete analize.

29. KARROTA

Treguesit cilësor të karrotës:

1.Pamja e jashtme

Të freskëta me ngjyrë të verdhë në të kuqerremtë,formë tipike të kultivarit,me përkulje të lehtë,të jenë të pastruara me ujë të pijshëm nga balta,.

2.Përbërja e brëndshme e tulit:

Me tul të fortë,me bosht të hollë,me diametër jo më shumë se 1 cm.

3.Madhësia

Gjërësia deri në 4 cm.Gjatësia 10-15 cmM

Dëmtime mekanike në % jo më shumë se 2..

4.Të prekura nga sëmundjet,insektet e kalbura:Nuk lejohen

Për produktet ushqimore te fresketa fruta-perime cdo sasi e mallit të lëvruar nga operatori ekonomik fitues do të shoqërohet me fletë analizat ku do te shenohet sasia e prodhimit qe i referohet kjo flete analize.

30. PATATE

Të jenë të cilësis të parë, të pa dëmtuara,jo të kalbura,të pa prera dhe me diametër 4-5 cm. Kokrra e patates të jetë e zhvilluar mirë nuk duhet të jetë me tepër se 1% të mbira dhe të mos kenë asnjë lloj sëmundje.

Të jenë të ambalazuara në thasë polietileni.

Për produktet ushqimore te fresketa fruta-perime cdo sasi e mallit të lëvruar nga operatori ekonomik fitues do të shoqërohet me fletë analizat ku do te shenohet sasia e prodhimit qe i referohet kjo flete analize.

31. KUNGULL

Treguesit cilësorë

- *Pamja e jashtme:* Të freskët, të njomë dhe të pastër. Me formë e ngjyrë tipike të kultivarit.
- *Fortësia:* Cipa gërvishtet me lehtësi.
- *Përbërja e tulit:* Me ngjyrë të bardhë në të verdhë. Me tul të shëndoshë, me fara të vogla të pa mbushura plotësisht (të porsa formuara).
- *Madhësia (Diametri më i madh gjerësor):* Deri në 4 cm.
- *Gjatësia e bishtit, cm, deri:* 2.
- *Dëmtime e sëmundje:* Lejohen deri 5 % të partisë me gërvishtje të lehtë në lëkurë. Nuk lejohen të çarë e të plasur.
- *Të prekur nga sëmundjet dhe insektet:* Nuk lejohen.

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit.

Transporti i perimeve të freskta bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjieno – sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

Për produktet ushqimore te fresketa fruta-perime cdo sasi e mallit të lëvruar nga operatori ekonomik fitues do të shoqërohet me fletë analizat ku do te shenohet sasia e prodhimit qe i referohet kjo flete analize.

32. LIMON

Klasifikimi

- **Lloji :** cilësi e parë, e freskët

Treguesit cilësorë

- *Pamja e jashtme:* Të freskët, me zhvillim normal. Me pjekuri teknike të plotë.

- Ngjyra, shija dhe aroma: Ngjyrë karakteristike e kultivarit e verdhë, me erë karakteristike dhe shije të thartë në të athët, pa shije të hidhur.

- Dëmtime mekanike: Nuk lejohen, të prekura nga sëmundjet dhe insektet, të kalbura, të mykura dhe të fermentuara, gjithashtu nuk lejohen lëndë të huaja, gërvishtje në sipërfaqe, por pa prekur tulin.

Ambalazhimi, etiketimi, verifikimi i kërkesave cilësore, ruajtja dhe transportimi Sipas SSH ISO 7558:1988 “Udhëzues për para paketimin e frutave dhe perimeve ose ekuivalentin e tij. Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organoleptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit. Transporti i frutave të freskta bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjieno – sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

33. BIZELE

- **Lloji: Bizele bishtajore e freskët, cilësi e parë**

Kërkesat cilësore

- *Pamja e jashtme dhe konsistenca:* të njoma, të freskëta, të pastra, të pathyera, me ngjyrë e madhësi të kultivarit.
- *Kokrrat në bishtajë:* Me madhësi normale të kultivarit, të zhvilluara mirë në fazën qumështore, me ngjyrë jeshile të hapur, me lëkurë të hollë, të njomë e të ëmbël, pa shenja drunjëzimi.
- *Madhësia e kokrrës:* normale sipas kultivarit.
- *Dëmtime mekanike, njolla ndryshku, nga antraknoza, ndezje e kalbje:* lejohen të vrara deri 5 % e masës. Nuk lejohen me njolla ndryshku nga antraknoza, ndezje e kalbje.

Ambalazhimi, etiketimi, verifikimi i kërkesave cilësore, ruajtja dhe transportimi

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organoleptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit.

Transporti i perimeve të freskta bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjieno – sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

Për produktet ushqimore te fresketa fruta-perime cdo sasi e mallit të lëvruar nga operatori ekonomik fitues do të shoqërohet me fletë analizat ku do të shenohet sasia e prodhimit që i referohet kjo flete analize.

34. MOLLË

Duhet të jenë të shëndosha, pa ndryshime cilesore dhe humbje në peshë, pa difekte, të pa vyshkura, të madhësisë dhe formës së rregullt.

Mollët, portokallet, bananet duhet të kenë peshë për çdo kokërr 180-200 gr.

Frutat e tjera sipas kërkesës së tregut.

Nuk lejohen të jenë të ngrira, gërvishje në sipërfaqe dhe pa erëra të huaja.

Nuk duhet të kenë dëmtime mekanike

Ambalazhimi duhet të jetë në arka druri, kartoni, plasmasi të pa dëmtuara.

Për produktet ushqimore te fresketa fruta-perime cdo sasi e mallit të lëvruar nga operatori ekonomik fitues do të shoqërohet me fletë analizat ku do te shenohet sasia e prodhimit qe i referohet kjo flete analize.

35. BANANE

Duhet të jenë të shëndosha, pa ndryshime cilesore dhe humbje në peshë, pa difekte, të pa vyshkura, të madhësisë dhe formës së rregullt.

Mollët, portokallet, bananet duhet të kenë peshë për çdo kokërr 180-200 gr.

Frutat e tjera sipas kërkesës së tregut.

Nuk lejohen të jenë të ngrira, gërvishje në sipërfaqe dhe pa erëra të huaja.

Nuk duhet të kenë dëmtime mekanike

Ambalazhimi duhet të jetë në arka druri, kartoni, plasmasi të pa dëmtuara.

Për produktet ushqimore te fresketa fruta-perime cdo sasi e mallit të lëvruar nga operatori ekonomik fitues do të shoqërohet me fletë analizat ku do te shenohet sasia e prodhimit qe i referohet kjo flete analize.

36. DARDHË

Treguesit cilësorë

- Pamja e jashtme, pjekuria, era dhe shija: Me zhvillim normal, të shëndosha, të pastra, me ngjyrë karakteristike të kultivarit, me pjekuri teknike dhe me bisht.
- Madhësia e kokrrës, mm (diametri më i madh gjatësor), jo më pak se:
 - o Për të rumbullaktat: 45.

-
- Për të gjatat: 40.
 - *Dëmtime mekanike,%, jo më shumë se:* Lejohen deri 5 % të partisë ose të numrit të kokrrave me dëmtime të lehta.
 - *Prekje nga sëmundjet, %, jo më shumë se:* Nuk lejohen.
 - *Dëmtime nga bryma, ngrica, të lagura dhe lëndë të huaja:* Nuk lejohen.

Ambalazhimi, etiketimi, verifikimi i kërkesave cilësore, ruajtja dhe transportimi

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjenike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit.

Transporti i frutave të freskta bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjieno – sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

Për produktet ushqimore te fresketa fruta-perime cdo sasi e mallit të lëvruar nga operatori ekonomik fitues do të shoqërohet me fletë analizat ku do te shenohet sasia e prodhimit qe i referohet kjo flete analize

37. PORTOKALLE

Bazuar në SSH 1722:1988 ose ekuivalentin e tij.

Klasifikimi

- **Lloji :** cilësi e parë, e freskët

Treguesit cilësorë

- *Pamja e jashtme:* Të freskët, me zhvillim normal, të shëndoshë e me bisht. Para dhe pas 15 janarit lejohen kokrra pa bisht përkatësisht 5 dhe 20 %. Me pjekuri teknike të plotë.
- *Ngjyra, shija dhe aroma:* Ngjyrë karakteristike e kultivarit, e verdhë në portokalli, me erë karakteristike dhe shije të ëmbël në të athët. Pa shije të hidhur.
- *Madhësia e kokrrës, (diametri më i madh) mm, jo më pak se:* 70.
- *Dëmtime mekanike, të prekura nga sëmundjet dhe insektet, të kalbura, të mykura dhe të fermentuara, gjithashtu lëndë të huaja, gërvishtje në sipërfaqe, por pa prekur tulin:* Nuk lejohen.
- Nuk lejohen as zbutje të kokrrave, ngrirje dhe lagje të sipërfaqes së tyre.

Ambalazhimi, etiketimi, verifikimi i kërkesave cilësore, ruajtja dhe transportimi

Sipas SSH ISO 7558:1988 “Udhëzues për para paketimin e frutave dhe perimeve” ose ekuivalentin e tij.

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjenike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit.

Transporti i frutave të freskta bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjieno – sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

38. MANDARINË

Bazuar në SSH 1778:1988 ose ekuivalentin e tij.

Klasifikimi

- **Lloji : cilësi e parë, e freskët**

Treguesit cilësorë

- *Pamja e jashtme:* Kokrra me zhvillim normal, të pastra, me bishta të prerë afër sipërfaqes së kokrrës. Me pjekuri teknike të plotë.
- *Ngjyra, shija dhe aroma:* Karakteristike për mandarinat, pa erë dhe shije të huaj. Grupi i satsumave dhe klementina me ngjyrë jeshile me nuancë të verdhë.
- *Madhësia e kokrrës (diametri më i madh), mm, jo më pak se:*
 - o *Për satsumat:* 50.
 - o *Për të tjerat:* 45.
- *Dëmtime mekanike:* Nuk lejohen, të prekura nga sëmundjet dhe insektet, të kalbura, të mykura dhe të fermentuara, gjithashtu nuk lejohen lëndë të huaja, gërvishtje në sipërfaqe, por pa prekur tulin. Nuk lejohen as zbutje të kokrrave, ngrirje dhe lagje të sipërfaqes së tyre.

Ambalazhimi, etiketimi, verifikimi i kërkesave cilësore, ruajtja dhe transportimi

Sipas SSH ISO 7558:1988 “Udhëzues për para paketimin e frutave dhe perimeve” ose ekuivalentin e tij.

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit.

Transporti i frutave të freskta bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjieno– sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

39. LULE LAKËR

Bazuar në SSH 1788:1988 ose ekuivalentin e tij.

Klasifikimi

- **Lloji : cilësi e parë, e freskët**

Treguesit cilësorë

- *Pamja e jashtme*: Të formuara dhe të ngjeshura, me ngjyrë të kultivarit, jo më shumë se 6 gjethe mbrojtëse të shkurtuara në majë dhe me gjatësi të koçanit deri 1 cm (matur nën gjethin e fundit mbajtës), të shëndosha, të pastra.
- *Dëmtime, %*:
 - o *Mekanike të lehta jo më shumë se*: 2
 - o *Nga sëmundjet e dëmtues të tjerë*: Nuk lejohen.
- *Madhësia e lulelakrës, kg*,
 - o *Të hershme, jo më pak se*: 0.300.
 - o *Të vona, jo më pak se*: 0.350.

40. BROKOLI

Te jene te fresket, te pjekur mire, me forme te rregullt, pa demtime mekanike. Te kene ngjyren karakteristike jeshile te forte te brokolit me permasa mesatare. Ambalazhimi dhe etiketimi bazuar ne standartin 1799\88. Perimet ambalazhohen të ndara sipas kultivarve ne arka të pastra të forta e të thata të prodhuara sipas standartit ose kushtit teknik të perkates ne fuqi. Çdo parti perimesh shoqerohet me etikete ku shenohet: Prodhuesi . Lloji i prodhimit. Cilesia . Masa bruto dhe neto.

41. TERSHERE

Bazuar ne STASH 1704-87 Treguesit Shqisore Pamja e jashtme:Te jete koërr tershere e shtypur, e paster pa insekte dhe perzierje te huaja. Ngjyra karakteristike e tersheres,e bardhe ne te verdhe te celur. Shija dhe era karakteristike e tersheres pa shije dhe ere myku dhe cfardo ere dhe shije tjeter te huaj. Demtues hambari te gjalle: Nuk lejohen. Treguesit Fiziko-Kimike Lageshtia në % jo me shume se 14. Lende te huaja , insekte, papasterti nuk lejohen. Ambalazhimi: Ambalazhimi i paketuar me pako me peshe 400 gr - 1 kg, e etiketuar Markerimi: Emërtimi i prodhuesit. Emri i produktit . Peshë neto ose vëllimi i produktit. Data e prodhimit . Data e skadimit. Kushtet e vecanta të ruajtjes. Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë. Malli duhet të shoqerohet me raport analizë te rregullt sipas legjislacionit në fuqi. Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e kërkuara. Raport Analiza duhet të paraqitet në original ose fotokopje e noterizuar.

42. KANELLE

Kerkesat cilesore Pamja: Pluhur i thatë, e shije dhe erë karakteristike të kanellës. Ngjyra: E kuqërremtë Nuk lejohen papasterti te ndryshme. Treguesit Fiziko –Kimike Lageshtia: Jo me shume se 14% Lende te huaja: Nuk lejohen Ambalazhimi: Ne paketime te vogla , te pastra, pa lageshti, pa ere te huaj, me peshe nga 30gr - 100gr. Ne paketim duhet te jete e bashkangjitur dhe emri tregetar, data e prodhimit ,vendi i prodhimit,menyra e ruajtjes dhe skadencia. Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm. Raport Analiza duhet të paraqitet në original ose fotokopje e noterizuar.

43. RIGON

Bazuar ne SSH 2422:1994 ose ekuivalentin e tij.

Klasifikimi

-
- Lloji: cilësi e parë.

Kërkesat cilësore

Treguesit shqisorë:

- *Pamja e jashtme:* Fletë e lule të thara, të shkoqura nga kërcelli i bimës. Aroma dhe shija karakteristike të vetë bimës.
- *Ngjyra:* Fleta e gjelbërt, e gjelbërt në të hirtë dhe e gjelbërt në të verdhë. Lulja e bardhë, e verdhë deri në bezhë.

Treguesit fiziko- kimik:

- *Lagështira,*%, max 13.
- *Pjesë të bimës (kërcej) me gjatësi deri në 10 mm,* %, max 5.
- *Fletë e lules me ngjyrë jo normale,* %, max 3.
- *Pluhur organik nga copëtimi I bimëve me madhësi deri 0.5 mm,* %, max 5.
- *Hiri I patretshëm në HCl,* %, max 0.5.
- *Të mykura e të kalbura,* % nuk lejohen.

Ngarkesa mikrobiale:

- Brenda normave të lejuara sipas Udhëzimit i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Nr. 15, datë 9.9.2021 “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”.

Ambalazhimi, etiketimi, ruajtja dhe transportimi.

Sipas SSH 2500:1988 “ Bimë mjekësore, eterovajore dhe tanifere. Ambalazhimi, etiketimi, ruajtja dhe transportimi” ose ekuivalentin e tij.

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit.

Erëza ambalazhohet në ambalazhim plastik ose letre me vëllime sipas kërkesave të AK-së.

Mbi çdo ambalazh vendoset etiketa ku shënohen:

- Emërtimi i prodhuesit,
- Emri i produktit,
- Pesha neto,
- Data e skadimit,
- Kushtet e vecanta të ruajtjes.

Transporti të behet me mjete të pastra të mbrojtura nga faktoret atmosferike duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore dhe që nuk ndikojnë në karakteristikat dhe cilësinë e produktit dhe sigurojnë ruajtjen e tij higjienike.

44. LENG LIMONI

Shija dhe era:Tejete me ere dhe shijen e limonit te fresket. Te jete i ambalazhuar ne shishe plastike me peshe 250ml.. Ne shishe te jete e shenuar : Emertimi i prodhuesit Emertimi i produktit. Pesha neto Data e skadimit Kushtet e vecanta te ruajtjes Malli të shoqërohet me certifikatë origjine dhe raportë analize të laboratorit.

45. PJEPER

Kerkohe të përpunuesit të jete cilësore të pjekurisë të plote teknike, me permashje mesatare. Nuk lejohen demtime mekanike, demtime nga insektet, të mykur apo të kalbur. Frutat ambalazhohen të ndara sipas kultivareve në arka të prodhuara sipas standarteve dhe kushteve teknike në fuqi për çdo lloj fruti dhe të pastra.

46. PJESHKE

Kerkohe cilësia e pjekurisë, kokrra të jete e fresketa, me zhvillim normal, me ngjyres karakteristike të kultivarit, të pasterta, pa bishta, me shije të embel dhe ere karakteristike të kultivarit. - Të jete me pjekuri të plote teknike, - Madhësia e kokrrës të jete për të hershmet deri në 50 mm, gjysem të hershme deri në 55 mm dhe të vonshme deri në 60 mm. - Demtime mekanike nuk lejohen. - Demtime nga semundjet, insektet, dielli, ndryshim ngjyre të jete jo me shumë se 5 %. - Të mykura, të fermentuara, të kalbura dhe lende të huaja nuk lejohen.

45. KIVI

Kerkohe cilësia e pjekurisë, të fresketa, me zhvillim normal, me pjekuri të plote. Ngjyra të jete kafe në sipërfaqe dhe jeshile në brendësi, me ere dhe arome të këndshme karakteristike të kultivarit. Madhësia e kokrrës të jete mesatare. Demtime mekanike nuk lejohen. Njolla të errta që tregojnë tejkalimin e pjekurisë nuk lejohen. Gervishtje të lekures nuk lejohen. Zbutje të lekures nuk lejohen. Ambalazhimi të jete në kuti kartoni standarte, sipas kërkesës së AK

Verifikimi i kërkesave cilësore:

Autoriteti kontraktor përpara se të marrë dorëzim produktin do të vlerësojë treguesit organoleptikë të cilët duhet të jenë në përputhje me specifikimet e këtyre treguesve.

Kontraktuesi duhet të dorëzojë raport analizë nga një laborator i autorizuar i kontrollit ose i referencës për treguesit fiziko-kimikë dhe për ngarkesën mikrobiale, të cilët duhet të jenë në përputhje me specifikimet e këtyre treguesve.

Raport Analiza "Fiziko-Kimike" dhe "Ngarkesën Mikrobiale" duhet të paraqitet në origjinal, ose fotokopje të noterizuara.

Ambalazhimi, etiketimi, verifikimi i kërkesave cilësore, ruajtja dhe transportimi

Sipas SSH 1799:1988 "Perime. Ambalazhimi, etiketimi, verifikimi i kërkesave cilësore, ruajtja dhe transportimi" ose ekuivalentin e tij.

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organoleptike të produktit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm për qëllimin e përdorimit.

Transporti i perimeve të fresketa bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjieno – sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

Shënim:

Për ushqimet dhe produktet ushqimore¹, do të zbatohen dispozitat e Legjislacionit për ushqimin.

Për artikujt ushqimor të mësipërm, ku kërkohet raport analizë, operatori ekonomik duhet të paraqes raport analizë origjinale ose kopje të noterizuara, lëshuar nga një laborator i referencës ose i akredituar sipas legjislacionit në fuqi. Raport analizë përkatëse (fletë analizë për treguesit e

¹Produkte ushqimore janë ato të përcaktuara, sipas parashikimit të nenit 3, pika 1 të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 "Për ushqimin", I ndryshuar.

sigurisë dhe cilësisë) duhet të jetë sipas llojit të produktit, numrit të lotit dhe jetëgjatësisë së produktit dhe të ketë lidhje me produktin. Në raport analizë duhet të jetë shënuar: emërtimi i produktit ose një e dhënë tjetër që tregon ose lidh këtë raport analizë me produktin.

Produkti kur të lëvrohet duhet të jetë i shoqëruar me certifikatën e origjinës sipas legjislacionit në fuqi për ushqimin.

Produktet ushqimore, objekt i vendimit të këshillit të ministrave nr. 1344 datë 10.10.2008 “Për miratimin e rregullave për etiketimin e produkteve ushqimore”, neni 4 dhe neni 13, të jenë të pajisura me etiketat respektive.

Për produktet mishi/ i përpunuar mishi.

Pjesa e karkasës (shpatull, kofshë dhe gjoks) duhet të jetë e vulosur me vulën e kontrollit veterinar.

Çdo parti/karkasë mishi duhet të shoqërohet me certifikatë veterinare, e cila garanton sigurinë e produktit “mish” dhe me të cilën vërtetohet se, nga kontrolli i kryer nuk është prekur nga sëmundje, por që është i sigurt dhe se lejohet të tregtohet për konsum publik.

Për produktet ushqimore të freskëta të fruta-perimeve të pa përpunuara, do të zbatohen dispozitat e Legjislacionit për ushqimin.

Në fletë analizat që do shoqërojnë çdo sasi të mallit të lëvruar, operatori ekonomik të shënojë sasinë e prodhimit që i referohet kjo fletë analizë.

Mbi ambalazhimin e artikujve ushqimor të zbatohen dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Autoriteti Kontraktor, në momentin e lëvrimit të mallit, do të verifikojë jetëgjatësinë e produktit me të cilin do të furnizohet, në përputhje me periudhën e parashikuar të konsumimit nga AK të produktit.

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT**Sasia e mallit që kërkohet:****Afatet e lëvrimit: 11 muaj**

Objekti: Blerje ushqime per kopshtin dhe çerdhen

Nr	Emertimi i artikullit	Njesia	Sasia	Cmimi pa tvsh	Vlera
1	Buke thekri	Kg	2200		
2	Bizele	Kg	318		
3	Qumesht	Litra	4500		
4	Djathe	Kg	100		
5	Veze	Kokrra	12998		
6	Reçel kumbulle	Kg	160		
7	Mish vici	Kg	560		
8	Mish pule	Kg	580		
9	Vaj ulliri	Litra	380		
10	Miell	Kg	240		
11	Makarona spageti	Kg	200		

12	Makarona supe	Kg	60		
13	Oriz	Kg	330		
14	Kripe	Kg	70		
15	Sheqer	Kg	300		
16	Qepe	Kg	153		
17	Patate	Kg	1290		
18	Karrota	Kg	900		
19	Kos	Litra	3109		
20	Fruta stine	Kg	2000		
21	Miell misri	Kg	120		
22	Molle	Kg	230		
23	Tershere	Kg	300		
24	Trahana	Kg	160		
25	Domate	Kg	583		
26	Gjize	Kg	191		
27	Gjalpe	Kg	30		
28	Thjerreza te vogla, te kuqe ose jeshile	Kg	238		
29	Fasule	Kg	180		
30	Zarzavate (spinaq, brokoli,lule laker,kungull)	Kg	726		
31	Banane	Kg	825		
32	Tranguj	Kg	180		
33	Presh	Kg	280		
34	Kanelle	Kg	1		

35	Rigon i thate	Kg	2		
36	Pluhur pjekje	Kg	5		
37	Miell orizi	Kg	80		
38	Selino	Kg	5		
39	Limon	Kg	10		
	Shuma pa tvsh				
	Tvsh				
	Totali me tvsh				

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë:

- Liçencë, kategoria II.1. A.1 “Për prodhim, perpunim dhe shpërndarje me shumicë të ushqimeve për njerëz” të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

Shenim: Nuk lejohet përdorimi i licenses se nje operatori tjetër ekonomik (Rekomandim i përbashkët i APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2020, 2021, 2022), të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në një vlerë **jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose/dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të operojë duke plotësuar standartet në fuqi për sigurinë ushqimore. Për këtë ai duhet të paraqesë vetëdeklarim, ku të deklarojë se nga kontrolli i fundit ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

2.3.3 Operatori Ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë në pronësi ose në përdorim, një automjet të përshtatshëm ATV (frigorifer), për të bërë transportimin e mallrave pranë magazinës, në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara, të vërtetuar me dokumentacionin e duhur tekniko-ligjor, leje qarkullimi, policen e sigurimit, certifikatën e kontrollit teknik si dhe certifikatën e pronësisë të mjetit.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra

në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me certifikata cilësie në gjuhën shqipe ose të përkthyer dhe të noterizuara, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Certifikata e kërkuar është si më poshtë:

- ISO 22000:2018 (Sistemet e Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore) ose ekuivalente.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë **një deklaratë**, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit** në adresat e përcaktuara nga autoritetet kontraktore.

Ofertuesi i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe brenda afatit të përcaktuar në kërkesën për dorëzim dokumentacioni pranë AK, dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të parashikuara në pikën 2 të nenit 26 të VKM-se nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 8

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
_____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

•
nformacion mbi subjektet

mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në

fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
 - a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
 - b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
